

V E N D I M
Nr.30, datë 28.1.1999

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Avni Shehu	Kryetar
Agim Shkupi	Anëtar
Natasha Sheshi	“
Vangjel Kosta	“
Petrit Plloçi	“
Agim Gjoleka	“
Metush Saraçi	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Tefta Zaka	“

Në seancën gjyqësore të datës 28.1.1999 mori në shqyrtim çështjen penale nr.134/19 që i përket :

TË PANDEHURIT: Bledar Hoxha mbrojtur nga avokat Adem Klari

AKUZA: Vrasje me dashje, në tentativë dhe armëmbajtje pa leje.

Nenet 76, 76-22, dhe 278/2 të Kodit Penal.

Gjykata e rrethit Durrës me vendimin nr.73 datë 24.4.1998 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Bledar Hoxha për krimin e vrasjes me dashje indirekte të shtetasit Ervin Maliqi, për vrasje me dashje në tentativë, armëmbajtje pa leje dhe në bazë të neneve 76, 76-22, 278/2, 55/2 dhe 51 të Kodit Penal e dënon përfundimisht me 10 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 58 datë 19.6.1998 ka vendosur :

Moapranimin e ankimit të bërë nga avokat Adem Klari.

Kundër vendimit të gjykatës së Apelit ka bërë rekurs avokati i të pandehurit Adem Klari duke parashtruar këto shkaqe:

Vendimi është i gabuar .

Si avokt i caktuar kryesisht nga gjykata unë kam marrë pjesë në dy shkallët e gjykimit .

Nuk kërkohet të kemi akt përfaqësimi sipas nenit 410/2 të Kodit të Procedurës Penale sepse i pandehuri është i mitur dhe jam avokat i të pandehurit me një vendim gjykate.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Të angazhuara me vendimin nr. s'ka datë 9.12.1998 për unifikim të praktikës pasi dëgjuan relacionin përkatës, prokurorin Arqile Lole që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës Apelit Durrës, avokatin Adem Klari që kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së Apelit dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.73 datë 24.4.1998 të gjykatës së rrethit Durrës i pandehuri Bledar Hoxha në mungesë është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të vrasjes dhe në tentativë dhe armëmbajtje pa leje.

Kundër këtij vendimi ka bërë apel avokati i të pandehurit të mitur dhe të caktuar

kryesisht nga gjykata e rrethit.

Gjykata e Apelit Durrës nuk ka shqyrtuar ankimin dhe ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se avokati nuk është i pajisur me akt përfaqësimi, siç kërkon neni 410/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Kolegjet e Bashkuara të investuara nga vendimi i Kolegjit Penal nr s'ka datë 9.12.1998, mbështetur në nenin 9 të ligjit nr. 8362 datë 1.7.1998 gjejnë me vend të dalin me një vendim unifikues lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 410/2 të Kodit Pr.Penale, për të pandehurin e mitur, në mungesë, të përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht.

Ndryshe nga ç' arsyeton gjykata e Apelit Durrës në rastin në gjykim përderisa organi procedues dhe gjykata në të gjitha fazat, të pandehurit të mitur, në mungesë i kanë caktuar kryesisht me vendim, avokatin mbrojtës Adem Klari. Duke u caktuar avokati si përfaqësues i të pandehurit me vendim të gjykatës nuk është e nevojshme që ai të pajiset me akt përfaqësimi tjetër nga vetë i pandehuri apo të afërmit për të apeluar vendimin e dënimit të tij nga gjykata e shkallës së parë.

Të pandehurit të mitur dhe aq më tepër në mungesë, garancia e sipërme buron dhe nga nenet 1 dhe 6 të Kodit Pr. Penale dhe nr.17,28 dhe 31 të Kushtetutës, të cilat janë në përputhje dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e të Miturve.

Detyrimi ligjor i parashikuar nga neni 410/2 i Kodit Pr Penale që kundër vendimit të dhënë në mungesë , mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi, duhet të kuptohet për mungesën dhe largimin e vullnetshëm të pandehurit, të parashikuar nga neni 352 të Kodit Pr.Penale.

Nisur nga këto vendimi i gjykatës së Apelit Durrës për mospranimin e ankimit të avokatit të pandehurit Bledar Hoxha, duhet të prishet si i pambështetur në ligj dhe çështja të dërgohet për shqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues sipas neneve 425 e vijues të Kodit të Pr. Penale.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 441/ç të K.Pr. Civile

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr. 58 datë 19.6.1998 të gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e akteve për shqyrtim në po atë gjykatë me trup tjetër gjykues.

Ky vendim është unifikues.